

## KONTRATË PËR SHITJEN E PJESEVE TE KAPITALIT

Sot me date 30/06/2022 , ne Tirane, shtetasit e meposhtem u ulen dhe redaktuan kete kontrate shitje kuotash.

### *PALET NE KONTRATE*

1- Awad Ata Mohamed Alim nenshtetas Sudanes lindur ne Khartoum me date 02.10.1967 me numer Pasaporte B00019936 . (me poshte referuar si "Shitesi")

Dhe

2- Ibrahim Muhamedit Maki Elfaki nenshtetas Sudanes, lindur ne Omdurman me date 06.09.1968 numer Pasaporte P02399858 .(me poshte referuar si "Blerësi"),

te dyja palet me aftesi te plote per te vepruar, me vullnet te lire, duke iu permbajtur dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, pranojne te lidhin dhe ne fakt lidhin kete Kontrate per Shitjen e Pjesëve sipas kushteve te meposhtme.

### *Kushtet paraprake*

Awad Ata Mohamed Alim eshte pronar i 1 kuote me vlere nominale 500 Leke qe perfaqeson 50% (pesedhjte perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur GREATLINKS, me seli ne TIRANE Rruga Ali Visha, Hyrja 1, Apartamenti 16, Tirane.

Pala shitese deklaron se kuotat e shoqerise "GREATLINKS" SHPK jane plotesisht te lira nga çdo lloji barre e sekuestroje apo pengu.

Pala shitese deklaron se ka marre prej pales blerese çmimin e shitjes per 500 lekë per 50% të kuotave si me siper dhe pagesa parashikohet ne nenin 2 ,pika 2.2.

Pala Blerese deshiron te bleje dhe Pala Shitese deshiron te shese 50% (pesedhejte perqind) te kapitalit te Shoqerise me vlere 500 Leke te zoteruar nga Pala Shitese,

sipas kushteve dhe afateve te meposhtme;

Bleresi ka analizuar, verifikuar dhe miratuar gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile te Shoqerise ne momentin e lidhjes se kesaj kontrate.

Meqë ekzistojnë këto kushte paraprake, palet bien dakort per sa me poshte vijon:

### **Neni 1 - Kushtet Paraprake**

Kushtet paraprake te siperpermendura jane pjese perberese e kesaj Kontrate.

### **Neni 2 - Blerja e pjeseve te kapitalit**

2.1. Pala Shitesi merr persiper t'i shese dhe transferoje Bleresit, dhe Bleresi merr persiper te bleje, 50% (pesedhejete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise te zoteruar nga Pala Shitese, teresisht te lira nga çfaredolloj detyrimi ne favor te te treteve, dhe me nje cmim te barabarte me vleren e tyre nominale 500 Lekë.

2.2. Pagimi i çmimit u be me para ne dore nga ana e Bleresit ne vlere 500 Leke, ne momentin e firmosjes se kontrates.

Pronesia i kalon pales blerese ne momentin e neneshkrimit te kesaj kontrate.

### **Neni 3 - Detyrime dhe garanci**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe ne çfaredolloj momenti tjeter te metejshem pas lidhjes se saj, Pala Shitese do t'i garantoje Bleresit, prane selise se Shoqerise, akses ne origjinalet e librave kontabel te Shoqerise dhe cdo dokument tjeter, prone ose sende qe aktualisht jane ne pronesi te Shoqerise, ose qe duhet me pas te behen te Shoqerise.

### **Neni 4 - Korrespondenca**

4.1. Te gjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera ndermjet paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorezohen prane selise se Shoqerise, dhe prane selise se Bleresit.

4.2. Tegjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera do te dergohen me ane te

letres rekomande ose me faks.

4.3. Çdo informacion, kerkese ose njoftim do te jete i vlefshem vetem nese ekzistojne kushtet e meposhtme: a) nese eshte derguar me faks, ne momentin ne te cillin eshte marre faksi; b) nese eshte derguar me leter rekomande, ne daten e dorezimit tek marresi qe do te vertetohet me fleten e kthimit.

#### **Neni 5 - Shpenzime dhe taksa**

Shpenzimet legale dhe kontabile, ashtu si edhe çfaredo shpenzimi tjeter qe lidhet me kete kontrate, si edhe shpenzimet per transaksione te perfshira ne to, do te jene ne ngarkim te pales qe i mbulon. Ne cdo rast, do te jene ne ngarkim te Bleresit.

#### **Neni 6 - Trashegimia dhe cedimi**

Kjo kontrate do te detyroje palet dhe do te jete e vlefshme midis tyre, ashtu edhe per trashegimtarete e tyre. Ne cdo rast, asnjera nga palet nuk mundet te kaloje te treteve kontraten pa miratimin me shkrim te pales tjeter.

#### **Neni 7 - Permbajtja e kontrates dhe ndryshimet**

Kjo kontrate perfshin teresisht marredheniet midis paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme qe jane te lidhura me kete objekt. Ndryshime te mundshme ose kufizimet e kesaj kontrate mund te behen vetem me shkrim, te nenshkruara nga te gjitha palet dhe t'i bashkengjiten asaj.

#### **Neni 8 - Origjinalet**

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale, ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkruara nga palet ...

### **Neni 9 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur, mosmarreveshja do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor TIRANE.

### **Neni 10 - E drejta e zbatueshme**

Kjo kontrate dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te disiplinohen e ushtrohen ne baze te se drejtes shqiptare.

### **Neni 11 - Vlefshmeria**

Kjo kontrate behet e vlefshme me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet.

Kjo kontrate nenshkruhet nga te dyja palet ne Tirane, me date 30/06/2022.

\* \* \*

Palet pasi lexojne aktin e mesiperme dhe e gjejne ate konform vullnetit te tyre te lire , e nenshkruajne ate ne prezencen e tyre.

Shitesi:

Awad Ata Mohamed Alim



Bleresi:

Ibrahim Muhamedit Maki Elfaki

